



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES

REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC

Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje

Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim

Odeljenje za Obrazovanje

Department for Education

-IV-

Nr. i prot.

Br. prot.

1004

Më

Dt.

30

12

2025

RAHOVEC - ORAHOVAC

PLANI VJETOR I PUNËS I DREJTORISË KOMUNALE PËR ARSIM PËR VITIN 2026

Drejtoria Komunale për Arsim për vitin 2026 ka përgatitur këtë plan vjetor, me anë të të cilit do të realizojë aktiviteteve dhe punë të shumta me qëllime, synime dhe prioritetë të qarta.

Qëllimet kryesore të DKA-së janë:

- Përmirësimi i kushteve për mësimdhënie frytdhënëse dhe cilësore,
- Mbarëvajtja e procesit edukativo - arsimor, dhe
- Arritja e sukseseve më të mëdha të nxënësve të të gjitha niveleve.

Synimet kryesore e DKA-së për vitin 2026 janë:

- Vazhdimësia e funksionalizimit të plotë të aktivave profesionale (AP) dhe Këshillave Drejtuese në secilën shkollë;
- Riparimet dhe investimet në efikasitet të energjisë në objektet shkollore;
- Mbarëvajtja e funksionimit të procesit edukativ në 3 çerdhet e reja për fëmijë dhe kujdesi i shtuar për mbarëvajtjen e ndërtimit të çerdhes së re në lagjen e epërme të qytetit;
- Vazhdimi i ndërtimit dhe përfundimi i 2 objekteve të reja të shkollave i shkollave të reja;
- Vazhdimi i furnizimit të bibliotekave të shkollave me libra, pajisja e shkollave me mjete konkretizimi e laboratorike, me pako pedagogjike tashmë të zgjeruar për të gjitha nivelet dhe furnizimi i tyre me inventarin e nevojshëm, në ato institucione arsimore, të cilat kanë nevojë;

Prioritetet themelore të DKA-së për vitin 2026 janë:

- Rivlerësim i nevojave për objektet shkollore në qytet dhe në fshatra, me investime për riparime apo ndërtim të shkollave fillore dhe të mesme sipas nevojës;
- Përmirësim i kushteve infrastrukturore të shkollave për të rritur cilësinë e arsimit;
- Masat për efikasitet energjetike në shkolla, duke aplikuar për fonde nga Fondi i Kosovës për Efikasitet të Energjisë;
- Investime në pajisje laboratorike, teknologji informative, tabela digjitale dhe furnizim me libra për bibliotekat shkollore;

- Fillimi i angazhimit për krijimin e kushteve infrastrukturore për kalimin e të gjitha institucioneve edukativo-arsimore në procesin e mësimin në një ndërrim.
- Digjitalizim dhe vizualizim i materialeve mësimore për nxënësit nga parashkollorja deri në klasën e nëntë;
- Bashkëpunim i përhershëm midis organeve drejtuese të shkollave, këshillave të prindërve dhe nxënësve;
- Angazhim i psikologëve dhe i pedagogëve për mbështetje profesionale në shkollë;
- Ofrim i trajnimeve profesionale për mësimdhënësit, me fokus te mësimdhënësit fillestarë;
- Monitorim i vazhdueshëm i procesit edukativo-arsimor nga ekipi i DKA-së;
- Funkcionalizim i plotë i çerdhes së re në qytet, planifikuar për përfundim në vitin 2025;
- Organizim i garave periodike të diturisë për nxënës të të gjitha niveleve;
- Monitorim i përdorimit të pakos pedagogjike në shkollë;
- Vazhdim i funksionimit të qendrave arsimore për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për edukim shtesë;
- Vazhdim i funksionimit të qendrave të karrierës në shkollat profesionale "Xhelal Hajda-Toni" dhe "Selajdin Mullabazi – Mici";
- Bursa për studentë dhe nxënës, përkrahje për profesionistët që na përfaqësojnë me sukses;
- Subvencionimi i policës së sigurimit shëndetësor për të gjithë fëmijët në institucionet për edukim në fëmijërinë e hershme.
- Edukim dhe përkrahje për nxënësit me nevojë të veçanta, duke ofruar transport dhe kushte të përshtatura për mësim;
- Organizim i vizitave shëndetësore sistematike në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe QKMF-në.

➤ **Në tremujorin e parë**, përveç që do të analizohet vijueshmëria, mbarëvajtja dhe suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të parë, do të bëhen përgatitjet e nevojshme për fillimin e gjysmëvjetorit të dytë. Do t'i mbajmë aktive aktivet profesionale në secilën shkollë, të cilat do të jenë në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Këshillat Drejtuese të Shkollave dhe me DKA-në. Do të vazhdojmë me zbatimin e projektit të riparimeve në shkollë dhe me mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të objekteve shkollore, në kuadër të zbatimit të kontratave që kemi në vazhdim. Po ashtu, do të punojmë që të mos ndalojnë së zbatuari projektet për eficiencë të energjisë në disa shkollë. Do të zhvillojmë aktivitete kulturore dhe garuese me nxënës për nder të festave të 17 shkurtit dhe 7 Marsit. Do t'i organizojmë dhe mbajmë garat shkollore dhe komunale për olimpiadën e matematikës dhe të lëndës së fizikës. Do të nisim projektet e parapara me planin e prokurimit do të bëjmë shpërndarjen e librave nëpër biblioteka shkollore sipas kërkesave të shkollave e poashtu edhe pajisjet dhe mjetet konkretizuese, projekte këto që u realizuan në vitin që sapo lamë pas, por që do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2025.

➤ **Në tremujorin e dytë**, DKA do të angazhohet me anë të ekipeve të saj dhe në koordinim me aktivet profesionale të shkollave, do të ndër marrë veprime për t'u siguruar që ecuria e procesit të realizimit të planprogrameve mësimore dhe pakos pedagogjike po ecën mirë. Do të mbajmë gara të diturisë me nxënësit e të gjitha niveleve dhe të shumicës së lëndëve mësimore. Poashtu, do të bëhen përgatitje dhe do të organizohen provimi i maturës për nxënësit e klasave të 12-ta dhe testi i arritshmërisë për nxënësit e klasave të 9-ta. Pas përfundimit të tyre, do të analizohen rezultatet

e arritshmërisë të maturantëve dhe semimaturantëve. Do të zhvillojmë takime të rregullta me drejtorët e shkollave dhe me kolektivat e shkollave, me ç'rast do të bëhet një analizë e përgjithshme e procesit mësimor gjatë vitit mësimor. Në këtë periudhë, DKA do të pranojë dhe analizojë raportet e punës së ekipeve të saj profesionale dhe do të përcjellë hap pas hapi ecurinë e projekteve të ndërtimit të shkollave të reja dhe çerdhes për fëmijë në lagjen e epërme të qytetit.

Në gjashtëmujorin e parë synimi ynë kryesor do të jetë përmbyllja e vitit mësimor me një zvogëlim të ndjeshëm të mungesave të nxënësve, sidomos në Shkollat e Mesme të Larta dhe ngritja e nivelit të cilësisë në Arsim, në të gjitha nivelet. Po ashtu, në kuadër të DKA-së në këtë periudhë do të nisin procedurat për shumicën e projekteve të parashikuara.

- Në tremujorin e tretë, do të bëhet planifikimi i kuadrit mësimor për vitin shkollor 2025/2026 si dhe do të fokusohemi edhe në riparimin e objekteve shkollore përmes zbatimit të kontratës për riparime në shkolla. Do të analizohen sukseset dhe mangësitë e vitit shkollor paraprak dhe do të bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2026/2027. Në këtë periudhë, do të bëhet gati edhe planifikimi i projekteve kapitale për arsim për vitin pasues, dhe përmes kontratave të lidhura do të bëhet furnizimi i bibliotekave të shkollave me libra, mjete konkretizimi, pajisje laboratorike dhe të teknologjisë informative. Do të bëhet furnizimi me lëndë djegëse për ngrohje për të gjitha shkollat dhe institucionet edukativo - arsimore para muajit nëntor dhe do të përcillet vazhdimisht realizimi i projekteve kapitale në fushën e arsimit.
- Në tremujorin e katërt, do të mbahen takime me drejtorët e shkollave dhe me koordinаторët e cilësisë për mbarëvajtjen e procesit edukativo arsimor për periudhën e parë vlerësuese të vitit të ri shkollor dhe për ecurinë e zbatimit të planprogrameve mësimore. Gjithashtu, do të vizitohen të gjitha shkollat, me ç'rast do të koordinohen veprimet me aktivet profesionale të shkollave. Do të përcjellim në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e qendrave mësimore, në të cilat zhvillohet mësimi plotësues e po ashtu do të zhvillohen aktivitete të ndryshme inovative nga qendrat e karrierës. Drejtori i DKA-së do të realizojë vizita e takime të njëpasnjëshme me këshillat e arsimtarëve të çdo institucioni edukativo - arsimor.

Në gjashtëmujorin e dytë, synojmë t'i arrijmë qëllimet tona për t'i realizuar dhe përfunduar me kohë, sipas afateve të përshkruara nëpër kontrata, të gjitha projektet kapitale dhe projektet e planifikuara që kanë të bëjnë me mallra e shërbime për furnizimin e shkollave. Të gjitha këto angazhime, punë dhe aktivitete, do të jenë në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim.


Afrim Limani
U.D i Drejtorit të DKA-së